

Në kuadër të bashkëpunimit ndërkombëtar, të pjesëmarrjes së Komisionerit me të Drejtë vote në *“Komitetin Konsultativ mbi Konventën për Mbrojtjen e Individëve nga Përpunimi Automatik i të Dhënave Personale”* (T-PD) të Këshillit të Evropës, institucioni ynë ndjek me korrrektësi çdo arritje, çdo synim, çdo rekomandim që tenton dhe kërkon të forcojë mbrojtjen e të dhënave personale, elementët e rëndësishëm të saj, si garanci e lirive themelore të të drejtave të njeriut, privatësisë së individit. Megjithëse ende nuk jemi shtet anëtar i BE-së, kërkesat tona, hapat tonë ndërmerren vetëm me dëshirën dhe vullnetin për t’iu bashkuar familjes së madhe evropiane, për të kontribuar drejtëpërdrejtë në çështjet e trajtuara nga Këshilli i Evropës në fushën e mbrojtjes së të dhënave personale.

Edhe rekomandimi më poshtë kërkon njohje, marrje në konsideratë dhe implementimin e duhur në legjislacion.

REKOMANDIM MBI PROFILIZIMIN

- Duke pasur në konsideratë se përdorimi i profileve, edhe ligjërisht, pa masa paraprake dhe masat mbrojtëse të veçanta mund të dëmtojnë rëndë dinjitetin njerëzor, si dhe të drejtat dhe liritë e tjera themelore,
- Duke përfshirë të drejtat ekonomike dhe sociale dhe duke mbajtur parasysh se profilizimi i fëmijëve mund të ketë pasoja të rënda për fëmijët gjatë gjithë jetës së tyre edhe duke qenë se ata nuk janë në gjendje, që të shprehin pëlqimin në emër të tyre, për të siguruar garancitë e duhura për mbrojtjen e fëmijëve,

Është e nevojshme për të marrë parasysh interesat më të mira të fëmijës dhe zhvillimin e personalitetit të tyre në përputhje me Konventën e Kombeve të Bashkuara mbi Drejtat e Fëmijës.

Të ndodhur në këto kushte në datën 23 nëntor 2010 Komiteti i Ministrave i shteteve anëtare të Këshillit të Evropës ka miratuar Rekomandimin mbi mbrojtjen e individëve në lidhje me përpunimin automatik të të dhënave personale në kontekstin e profilizimit. Mbështetur dhe në Konventën e Krimit Kiberik (nr. 185- Konventa e Budapestit) e cila përmban rregullat për mbledhjen, ruajtjen dhe shkëmbimin e të dhënave, në përputhje me kushtet dhe masat mbrojtëse për të siguruar mbrojtje adekuate të të drejtave të njeriut dhe lirive, si dhe nenin 8 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (nr 5), që është interpretuar nga Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut, dhe rreziqet e reja të krijuara nga përdorimi i teknologjive të informacionit dhe komunikimit, mbrojtja e dinjitetit njerëzor dhe të drejtave të tjera themelore dhe liritë në kontekstin e profilizimit mund të jetë efektive nëse, dhe vetëm nëse të gjitha palët e interesuara kontribuojnë së bashku për një profil të drejtë dhe të ligjshëm të individëve. Rekomandimet e shteteve anëtare mbështeten në:

1. Zbatimin e shtojcës së rekomandimeve aktuale për mbledhjen dhe përpunimin e të dhënave personale të përdorura në kontekstin e profilizimit sidomos duke marrë masa për të siguruar që parimet e përcaktuara në shtojcën e rekomandimit;
2. Përhapjen e gjerë të parimeve të përcaktuara në shtojcën e rekomandimit midis personave, autoriteteve publike dhe organeve publike ose private, veçanërisht ato që marrin pjesë dhe përdorin profilizimin, të tillë si projektuesit dhe furnizuesit e softëare për pajisjet e komunikimeve

elektronike, projektuesit e profilit, ofruesit e shërbimeve të komunikimeve elektronike, si dhe midis organeve përgjegjëse për mbrojtjen e të dhënave dhe organeve të standardizimit;

- 3. Inkurajimin e personave të tillë si: autoritete publike dhe organeve publike ose private për të futur dhe nxitur mekanizmat vetë-rregulluese, të tilla si kodet e sjelljes, duke siguruar respektimin e privatësisë dhe mbrojtjen e të dhënave.***

SHTOJCË E REKOMANDIMIT

Ndër parimet e përgjithshme të shtojcës është se, Shtetet anëtare të Këshillit të Europës duhet të inkurajojnë hartimin dhe zbatimin e procedurave dhe të sistemeve, në përputhje me jetën private dhe mbrojtjen e të dhënave, tashmë në fazën e tyre të planifikimit, sidomos nëpërmjet përdorimit të teknologjive të zgjerimit-të privatësisë. Ata duhet gjithashtu të marrin masat e duhura kundër zhvillimit dhe përdorimit të teknologjive të cilat kanë për qëllim, në tërësi ose pjesërisht, shmangien e masave teknologjike të paligjshme dhe të mbrojtjes së intimitetit. Respektimi i të drejtave dhe lirive themelore, sidomos të drejtës së privatësisë dhe parimi i mos-diskriminimit, do të jenë të garantuara gjatë mbledhjes dhe përpunimit të të dhënave personale që i nënshtrohen këtij rekomandimi. Në këtë shtojcë janë përcaktuar kushtet për mbledhjen dhe përpunimin e të dhënave personale në kontekstin e profilizimit të cilat janë : ligjshmëria, cilësia e të dhënave dhe të dhënat sensitive. Në këto kushte sanksionohet se mbledhja dhe përpunimi i të dhënave personale në kontekstin e profilizimit duhet të jete e drejtë, e ligjshme dhe proporcionale dhe për qëllime të specifikuara dhe legjitime. Të dhënat që përdoren në kontekstin e profilizimit duhet të ruhen në një formë që të lejojnë identifikimin e subjekteve të të dhënave për një periudhë jo më shumë se është e nevojshme për qëllimet për të cilat ato janë mbledhur dhe përpunuar. Kontrolluesi duhet të marrë masat e duhura për të korigjuar të dhënat e pasakta dhe për të kufizuar rrezikun e gabimeve në profilizimet e natyrshme. Profilizimi i të dhënave sensitive në kontekstin e profilizimit është i ndaluar, përveç nëse këto të dhëna janë të nevojshme për qëllime të ligjshme dhe të veçanta të përpunimit dhe për sa kohë që e drejta e brendshme siguron masa mbrojtëse të përshtatshme. ***Ligji vendas duhet të ofrojë sanksione dhe mjete juridike të përshtatshme në rastet e shkeljes së dispozitave të ligjit vendas duke i dhënë fuqi parimeve të parashtruara në këtë rekomandim.***